



Prishtinë, 24 shtator 2018
Kodi i ZRRE: V_1028_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e nenit 16 dhe 22 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-0850);
- Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së);
- Vendimin e ZRRE-së nr. V_1018_2018, lidhur me Mesataren e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK);
- Vendimin e ZRRE-së nr. V_1019_2018, lidhur me cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakoren e humbjeve të lejuara për periudhën e dytë rregullative 2018-2022 për rrjetin e transmetimit (OST) dhe rrjetin e shpërndarjes (OSSH);
- Vendimin e ZRRE-së nr. V_1020_2018, lidhur me kategoritë dhe jetëgjatësinë e aseteve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Aplikacionin e Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT SH.A.), për të hyrat e Lejuara në kuadër të Shqyrtimit të periudhës së dytë rregullative (1 prill 2018- 31 mars 2023), të dorëzuar me datën 05 shtator 2017,

në seancën e mbajtur më 24 shtator 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (HLM në tekstin e mëtejme MAR)** që do të mbulohen nga Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut-KOSTT SH.A. përmes tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe tregut për periudhën e dytë rregullative-PRR2 (1 prill 2018- 31 mars 2023).

- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga KOSTT-i për periudhën e dytë rregulative janë përcaktuar në shumat e paraqitura në tabelë e mëposhtme.

Të Hyrat e lejuara Maksimale për PRR2	2018 € mil	2019 € mil	2020 € mil	2021 € mil	2022 € mil
Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut(KOSTT)	30.47	28.74	29.97	30.95	31.53

- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për KOSTT do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për Të Hyrat e OST/OT-së.
- IV. Të Licencuarit OST/OT duhet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim në ZRRE tarifat për shfrytëzim të sistemit të transmetimit/ operatorit të tregut të përcaktuar me MAR-in e këtij vendimi.
- V. Tarifat e propozuara nga OST/OT duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Përcaktimit Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operimit të Sistemit dhe operimit të Tregut dhe Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, të aprovuara nga ZRRE.

ARSYETIM

- 🚩 Rregulatori më datë 15 maj 2017 ka iniciuar shqyrtimin e dytë të periudhës rregulative (1 prill 2018- 31 mars 2023).
- 🚩 ZRRE më datë 05 shtator 2017 nga KOSTT ka pranuar aplikacionin për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale për PRR2,.
- 🚩 Rregulatori për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale(MAR) ka marrë parasysh dokumentet nxjerra dhe të publikuara në faqen zyrtare të saj:
 - Raportet Konsultative për: Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit, Jetëgjatësia e Aseteve dhe Caku për Reduktimin e Humbjeve, të publikuara më 4 korrik 2017;
 - Përgjigjet ndaj Komenteve për: Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit, Jetëgjatësia e Aseteve dhe Caku për Reduktimin e Humbjeve, të publikuara më 4 prill 2018;
 - Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OST/OT, i publikuar me datën 24 gusht 2018;
 - Raporti Konsultativ – Faktori i Efikasitetit, i publikuar më 24 gusht 2018;
 - Raport Konsultativ – Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 24 shtator 2018;
- Bordi i Rregulatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga operatori i i sistemit të transmetimit, operatori i tregut dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:



Arsim Janova, u.d kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.